

## RAPORT FINAL ANGAZHIMI

### I. HYRJJE

Në zbatim të Programit të Auditimit nr.790/1 prot, datë 31/07/2017 u krye auditim në Sektorin e Financës (Drejtoria e Financës dhe Administrimit të të Ardhurave) në ADISA, përfaqësuar nga z. Gëzim Kallajxhi me detyrë Drejtor, Drejtoria e Financës dhe Administrimit të të Ardhurave, znj.Eni Mirçe me detyrë Përgjegjës, Sektori i Financës me objekt: “ **Mbi hartimin e planifikimin e programit ekonomik për periudhën Janar 2016 - Qershor 2017, ndjekja e realizimit të tij, realizimi i shpenzimeve sipas zërave në programin ekonomik, pasqyrimi i drejtë i tyre në kontabilitet, mbajtja e azhurnimi i kontabilitetit sipa llogarive e nënlllogarive, problemet që kanë dalë në këtë drejtim, përputhja e dokumentacionit justifikues dhe pasqyrimi i saktë në bilancin e fund vitit**”.

Auditimi u krye në zbatim të Ligjit Nr.114 datë 22.10.2015, “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, Manualit të Auditimit të Brendshëm 2016, Kodit Etik për Auditët e Brendshëm dhe të Kartës së Auditimit të Brendshëm Publik, nga grupi i Auditimit z.Thoma Papadhimetri Përgjegjës grupi dhe znj.Shkurte Halili anëtar për periudhën 01.01.2016 deri më 30.06.2017.

Auditimi u krye mbi përputhshmërinë gjatë hartimit e planifikimit sa më të drejtë e real të treguesve kryesor të buxhetit për periudhën Janar 2016 deri më Qershor 2017, shpenzimeve të realizuara për zërat kryesor të buxhetit, ndjekja dhe realizimi i këtij programi, përputhja e dokumentacionit justifikues për çdo shpenzim të kryer, mbajtja e azhurnimi i kontabilitetit sipas llogarive e nënlllogarive, duke verifikuar dokumentacionin e përgjithshëm të këtij sektori. Përveç auditimit të dokumentacionit jemi bazuar dhe në ballafaqimin me stafin e këtij sektori.

Projekt raporti i angazhimit u mbajt në përfundim të misionit të angazhimit, mbi bazën e gjetjeve të konstatuara dhe rekomandimeve të dhëna sipas natyrës së gjetjeve i cili u dorëzua në sekretari me shkresën nr.790/1 prot, datë 11.10.2017.

Për këtë Projektraport Angazhimi nga nëpunësi përgjegjës janë kthyer observacionet përkatëse sipas shkresës nr.790/3 prot, datë 25/10/ 2017. Këto observacione pasi u shqyrtuan nga grupi i auditimit janë bërë rregullimet dhe sqarimet përkatëse dhe në përfundim u përgatit ky Raport Final Angazhimi.

### II. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE:

Nga misioni i auditimit të realizuar në Sektorin e Financës (Drejtoria e Financës dhe Administrimit të të Ardhurave) u konstatuan disa gjetje për të cilat janë lënë dhe rekomandimet për përmirësimin e punës në të ardhmen.

Veprimtaria e Sektorit të Financës është organizuar dhe ka funksionuar në zbatim të ligjit nr.9228, datë 20.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare,” i ndryshuar, Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Sektorin Publik” i ndryshuar, Ligjin

nr.10269, datë 08.07.2011 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Ligjit nr.13, datë 18.02.2016 “Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimit nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarte në zbatimin e buxhetit”, Aktit normative të KM nr.1, datë 29.07.2016 “Për disa ndryshime në ligjin nr.114/2015 “Për buxhetin e vitit 2016”, VKM nr.997, datë 10.12.2016 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, Brenda vendit”, i ndryshuar dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e këtij sektori.

Nga auditimi i dokumentacionit për periudhën e përfshirë në auditim rezultoi si më poshtë:

### ***Gjetjet kyçe të auditimit.***

#### ***1. Lidhur me planifikimin dhe shpenzimin e buxhetit u konstatua se:***

*Për vitin 2016 realizimi i buxhetit është në masën 51 % ose me një mosrealizim në vlerën 123,261 mijë lekë.*

#### ***2. Lidhur me mbajtjen dhe regjistrimin në kontabilitet të dokumentave të magazinës u konstatua se:***

*- Hyrje-daljet në magazinë nuk dokumentohen menjëherë, kështu që dhe dorëzimi tek nëpunësi përgjegjës për financat kryhet me vonesë.*

*- Regjistrimi i veprimeve në librat kontabël nuk është kryer në mënyrë sistematike dhe kronologjike, regjistrimi është kryer me shumë vonesë.*

*- Sektori i Financës nuk ka patur impenjimin e duhur për marrjen e këtij dokumentacioni dhe regjistrimin në librat kontabël duke bërë që: Këto dokumenta të mos kontrollohen nga financa për rregullshmërinë e tyre si nga ana e plotësimit të të dhënave që kërkon ky dokument po ashtu dhe kontrollin e veprimeve aritmetike, regjistrimi në kontabilitet të kryhet me vonesë, të mos kryhen rakordimet periodike me magazinën si dhe të mos nxirret në çdo kohë gjendja faktike e artikujve në magazinë.*

#### ***3. Lidhur me inventarizimin e kryer në fund të vitit 2016 u konstatua se:***

*- Gjendja kontabël e aktiveve afatgjata pasqyruar në pasqyrat financiare të vitit ushtrimorë 2016, nuk përputhet me gjendjen fizike të këtyre aktiveve sipas kartelave të inventarizimit të kryer, në shumën 127.680 lekë.*

*- Për inventarin individual (kompjuter, printer, tavolina etj) për çdo punonjës janë çelur kartelat individuale por nuk azhurnohen rast pas rasti me dorëzimet dhe marrjen në dorëzim të inventarit në ngarkim.*

*- Në kartelat e magazinës të plotësuara nga komisioni i inventarizimit, automjetet e institucionit janë evidentuar si aktive gjendje në magazinë, kur këto automjete janë në përdorim sipas nevojave të ADISA që nga momenti i marrjes në dorëzim.*

*- Për vitin 2017 Titullari i Institucionit me urdhër nr.219/1, datë 31.03.2017 “Për marrjen në ngarkim të automjeteve” me qëllim mirë administrimin e automjeteve në pronësi të ADISA, ka përcaktuar drejtoritë që marrin në ngarkim dhe do përdorin këto automjete sipas targave dhe*

*normativat e harxhimit të karburantit, por dhe pas këtij urdhëri makinat evidentohen si gjëndje në magazinë.*

*- Komisioni i ngritur për marrjen në dorëzim të objekteve në qytetet Krujë dhe Fier nuk ka tërhequr nga Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës dhe Ministria e Punëve të Brendshme kartelën shoqëruese të inventarit të ndërtesës që duhet të përmbajë (Vlerën fillestarë të ndërtesës, rikonstruksionet e kryera ndër vite, amortizimin si dhe vlerën e mbetur, më qëllim që këto dokumenta ti dorëzohen Sektorit të Financës për veprime të mëtejshme.*

*- Këto asete (ndërtesa) të marra në dorëzim nga ky komision dhe të kaluara në përgjegjësi administrimi të ADISA nuk janë evidentuar në regjistrin e aktiveve të ADISA.*

*- Vlera prej 18,927,255 lekë rikonstruksion i ndërtesës në Krujë është regjistruar në llogarinë 213 “Ndërtime e Rikonstruksione”, dhe jo në llogarinë 231 “Shpenzime në Proçess për Rritjen e AQT” duke qenë se ndërtesa ku është bërë rikonstruksioni nuk është regjistruar në Regjistrin e AQT të ADISA-s.*

*- Për evidentimin e aktiveve dhe lëvizjen e tyre është çelur dhe azhornuar regjistri i aktiveve, por ky regjister nuk është i hartuar sipas përcaktimeve në Udhëzimin nr.30 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Neni 3 “Rregjistrimi I aktiveve dhe dokumentimi I lëvizjes së tyre”, pika 30 .*

#### **4. Lidhur me auditimin për shpenzimet e kryera nga fondi i pagave për orët shtesë jashtë kohës normale të punës, të paguara rezulton se :**

*- Urdhëri nr.1292, prot, datë 11.11.2016 “Për kryerjen e orëve shtesë të punës” nuk është bazuar në MEMO apo kërkesë nga Drejtoria e Zhvillimit dhe Monitorimit të Standarteve ose ndonjë drejtori tjetër ,për nevojën për kryerjen e orëve shtesë jashtë kohës normale të punës nga punonjës të ndryshëm në sportele.*

*- Në pikën 3 të Urdhërit nr.1292 prot, datë 11.11.2016,Urdhërit nr.457/I prot, datë 26.04.2015 dhe Urdhërit nr.581/I prot, datë 26.05.2017 , i është kërkuar Sektorit të Financës pagesa e këtyre orëve për shkak se ka shumë fluks të aplikimeve në sportel, kërkesë e cila duhej të kryhej në fund të mbarimit të afatit sipas VKM nr.511, datë 24.10.2002 “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore”,i ndryshuar (brenda 2 muajve nga kryerja e orëve shtesë) nga përgjegjesit e këtyre zyrave ose Drejtori i Drejtorisë së zhvillimit dhe Monitorimit të Standarteve.*

*- Bazuar në urdhërat e cituar më sipër nga Sektori i Financës janë kryer pagesa për orët shtesë jashtë orarit zyrtarë, duke i shkaktuar një dëm ekonomik ADISA në shumën 1,155,734 lekë, kjo e detajuar sipas pasqyrës përfundimtare nr.1 me ndryshimet në vlera sipas punonjësve si pjesë përbërëse e këtij projektraporti.*

#### **5. Lidhur me auditimin për shpenzimet e kryera për karburant në përfundim të auditimit rezultoi se:**

- Për automjetet në pronësi të ADISA nuk ka libër automjeti ku të përcaktohen vlera e automjetit të bërë hyrje, shpenzimet për mirëmbajtjen, kilometrat e përshkruar, karburantin e furnizuar etj për secilin automjet.

- Për përcaktimin e normativave të harxhimit të karburantit për vitin 2017 është ngritur një grup pune i cili në përfundim të udhëtimeve të kryera me të gjitha makinat në pronësi të ADISA ka mbajtur proces verbal për çdo automjet duke përcaktuar rrugën e përshkruar dhe karburantin e harxhuar. Vihet re se automjetet Toyota PRIUS janë të një marke dhe të marra në dorëzim në të njëjtën datë me 0 kilometra dhe nga grupi i punës i ngritur për këtë qëllim janë përcaktuar normativa të ndryshme harxhimi karburanti për të njëjtën rrugë të përshkruar. Në përfundim të procesit nga ky grup duhej të përcaktohej një normativë e njëjtë duke llogaritur mesataren e harxhimit nga të 5 automjetet.

#### **6. Lidhur me auditimin e kryer mbi shpenzimet për udhëtime e dieta brenda dhe jashtë vendit u konstatua se:**

- Për periudhën e audituar dokumentacioni justifikues (Kuponi Tatimore) i urdhër shpenzimeve për udhëtime e dieta brenda vendit jashtë qendrës së punës, i lëshuar nga subjekte të ndryshme (hotelet), është i pavlefshëm pasi nuk kanë të shënuar numrin e Faturës Tatimore ose numrin serial të saj bashkëngjitur këtij kuponi, veprim që bie në kundërshtim me Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, VKM nr.781, datë 14.12.2009, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.16, datë 03.05.2010 “Për administrimin dhe dokumentimin e procedurave të paisjeve fiskale” pika 2.5.

- Nga Sektori i Financës janë bërë pagesa për udhëtime e dieta brenda vendit por jashtë qendrës së punës duke i shkaktuar një dëm ekonomik ADISA në shumën 462,000 lekë, kjo e detajuar sipas pasqyrës përmbledhëse nr.2 me ndryshimet në vlera sipas punonjësve si pjesë përbërëse e këtij raporti.

### **III. METODA E AUDITIMIT.**

Për auditimin e përputhshmërisë mbi hartimin e planifikimin e programit ekonomik për periudhën Janar 2016 Qershor 2017, ndjekja e realizimit të tij, realizimi i shpenzimeve sipas zërave në programin ekonomik, pasqyrimi i drejtë i tyre në kontabilitet, mbajtja e azhurnimi i kontabilitetit sipa llogarive e nënlllogarive, problemet që kanë dalë në këtë drejtim, përputhja e dokumentacionit justifikues dhe pasqyrimi i saktë në bilancin e fund vitit, u përdor metoda e auditimit të përgjithshëm të dokumentacionit pas vlerësimit të riskut të lartë të mjedisit të kontrollit që u krye në dokumentimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

Auditimi përfshin periudhën nga 01.01.2016 deri më 30.06. 2017.

Auditimi u krye gjatë periudhës 01.08.2017 deri më 25.09.2017 nga grupi i auditimit z.Thoma Papadhimitri Përgjegjës grupi dhe znj.Shkurte Halili anëtar.

Qëllimi dhe misioni i këtij auditimi është shqyrtimi dhe vlerësimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e tyre duke përdorur burimet financiare e

njerëzore në mënyrë ekonomike dhe eficiente, për arritjen e objektivave, në përputhje me legjislacionin në fuqi për periudhën objekt auditimi.

#### **IV. GJETJET DHE KONKLuzionET SIPAS PIKAVE TË PROGRAMIT:**

##### ***1. Ndjekja dhe zbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme.***

*Auditimi i fundit në Sektorin e Financës dhe Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse është kryer sipas Programit të Auditimit nr.1443/1 prot, datë 28.12.2016 “Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna gjatë auditimit mbi ligjshmërinë e administrimit të vlerave materiale në magazinë për vitin 2015”.*

*Në përfundim të auditimit u konstatua se rekomandimet e lëna janë marrë në shqyrtim ,3 prej tyre janë realizuar, 1(një) ishte në process dhe dhë 1(një) rekomandim nuk ishte realizuar.*

***Rekomandimi në process realizimi është kryerja e inventarizimit të pasurisë së ADISA në fund të vitit.***

*Gjatë auditimit të kryer u konstatua se sipas Urdhërit nr.1402 prot, datë 13.12.2016 “Për kryerjen e inventarizimit të aktiveve afatgjata material dhe jo material dhe aktiveve afatshkurtra” është kryer inventarizimi i pasurisë së ADISA nga një komision i përbërë nga 5 punonjës gjatë periudhës 14.12.2016 deri më 30.12. 2016 i cili në përfundim të inventarizimit ka hartuar dhe një relacion përmbledhës mbi gjendjen e aktiveve. Ky rekomandim është marrë në shqyrtim dhe quhet i realizuar.*

***Lidhur me rekomandimin mbi ushtimin e kontrolleve të vazhdueshme nga Sektori i Financës mbi dokumentacionin e mbajtur për evidentimin dhe lëvizjen e mallrave e materialeve në magazinë, dhe mbajtjen dhe plotësimin e këtyre dokumentave nga magazinieri sipas specifikimeve ligjore, në përfundim të auditimit u konstatua se vazhdojnë problematikat e ngritura mbi mbajtjen e dokumentacionit të Flete-daljeve ku kishte shumë të tilla të anuluar, numri i fletëdaljeve në vazhdim ishte po me të njëjtin numër etj.***

*Në përfundim të auditimit të kryer gjatë periudhës 01.08.2017 deri më 25.09.2017 u konstatua se për vitin 2017 këto dokumenta janë plotësuar në rregull dhe shoqëruar me dokumentin justifikues, kështu që ky rekomandim quhet i realizuar.*

***2. Hartimi dhe planifikimi i programit ekonomik për periudhën 01.01.2016 deri më 30.06.2017, ndjekja dhe realizimi i shpenzimeve buxhetore sipas zërave dhe kryerja e analizave periodike e vjetore mbi ecurinë e realizimit të treguesve të programit ekonomik për këtë periudhë, pasqyrimi i saktë në bilancin e fundvitit 2017.***

**Për vitin 2016,** ADISA ka hartuar projekt-buxhetin të ndarë në programe dhe projekte. Planifikimi buxhetor për vitin 2016 është bërë në mbështetje të ligjit nr.9938, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr.13/2016 “Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë” dhe udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.8. prot, datë 28.02.2015 “Për përgatitjen e programit buxhetor

afatmesëm 2016-2018”, për fazën e parë është përcjellë Ministrisë së Financave me shkresën nr.114 prot, datë 28.05.2015 “Dërgohet Projekt-Buxheti Afatmesëm 2016-2018.

Bazuar në shkresën nr.45 prot, datë 05.01.2016 të Ministrisë së Financës “Për miratimin e detajimit të investimeve për vitin 2016” ADISA me shkresën nr. 8/1 prot, datë 07.01.2016 ka dërguar në Ministrinë e Financave “Detajimin e investimeve publike për Agjencinë e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara”, ndërsa për fazën e dytë të PBA pas miratimit nga grupi i menaxhimit strategjik (GMS) në ADISA (të ngritur me Urdhër nr. 849 prot, datë 27.07.2016) është përcjellë në Ministrinë e Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, në afatin e përcaktuar, me shkresën nr.958/1 prot, datë 31.08.2016. Hartimi i treguesve të projektbuxhetit për fondin e pagave, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore është bërë në përputhje me dispozitat ligjore për to. Hartimi i treguesve të projektbuxhetit për vitin 2016, për fondin e shpenzimeve korrente dhe për investimet, është bërë mbështetur në realizimin e viteve të kaluara, si dhe nevojave në përputhje me objektivat prioritare të ADISA.

**Për vitin 2017 (6 mujori)** me shkresën nr.437 prot, datë 24.04.2017 është dërguar në Ministrinë e Inovacionit dhe Administratës Publike Kërkesa për Programin Buxhetor Afatmesëm 2018-2020 (faza e I), sipas afateve të përcaktuara në ligjin për buxhetin.

## 2.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Grupi i auditimit ka shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, si dhe shpenzimet sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelën e mëposhtë:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore

(në 000/lekë)

| Përshkrimi                     | Buxheti fillestar | Buxheti Final  | 2017(6-mujori) Realizimi | 2016 Realizimi | 2015 Realizimi |
|--------------------------------|-------------------|----------------|--------------------------|----------------|----------------|
| <b>Burimet e Fondeve:</b>      | <b>510,613</b>    | <b>393,784</b> | <b>225,888</b>           | <b>261,241</b> | <b>26,749</b>  |
| Granti i Qeverisë –Buxheti     | 88,248            | 89,194         | 97,995                   | 76,846         | 25,749         |
| Fondi i Zhvillimit të Rajoneve | 142,365           | 164,590        | 44,324                   | 53,685         | 1,000          |
| Financim i Huaj                | 280,000           | 140,000        | 83,568                   | 130,710        | 0              |

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar është pakësuar për 116,824 mijë lekë. Ky pakësim është rezultat i pakësimit të aplikuar pas rishikimit buxhetor dhe ndryshimeve të financimit të huaj.

Në vitin 2016 ADISA ka përdorur 77 % të buxhetit final ose 393,784 mijë lekë. Krahësuar me vitin 2015 janë përdorur 234,492 mijë lekë më shumë, më poshtë jepen shpjegimet për realizimin në fakt për vitin 2016.

Realizimi i shpenzimeve për periudhën Janar-Dhjetor 2016 paraqiten sipas tabelës më poshtë:

000/lekë

| Artikulli | Emertimi           | Plan 2016 | Buxheti vjetor, shtesa e pakesime | Buxheti vjetor final | Fakti 2016 | Diferenca 2016 |     |
|-----------|--------------------|-----------|-----------------------------------|----------------------|------------|----------------|-----|
| 600       | Paga               | 57,000    | 2,395                             | 59,395               | 51,954     | 7,441          | 87% |
| 601       | Sigurime Shoqërore | 7,600     | 2,586                             | 10,186               | 8,554      | 1,632          | 84% |

|                     |                              |                |                 |                |                |                |            |
|---------------------|------------------------------|----------------|-----------------|----------------|----------------|----------------|------------|
| 602                 | Mallra dhe Shërbime të Tjera | 23,618         | -4,005          | 19,613         | 16,338         | 3,275          | 83%        |
| <b>Nen-Totali</b>   | <b>Shpenzime Korrente</b>    | <b>88,218</b>  | <b>976</b>      | <b>89,194</b>  | <b>76,846</b>  | <b>12,348</b>  | <b>86%</b> |
| 230                 | Kapitale të Patrupëzuara     | 127,660        | -24,609         | 103,051        | 20,610         | 82,441         | 20%        |
| 231                 | Kapitale të Trupëzuara       | 14,705         | 46,834          | 61,539         | 33,072         | 28,467         | 54%        |
| 230                 | Kapitale të Patrupëzuara     | 200,000        | -100,000        | 100,000        | 98,872         | 1,128          | 99%        |
| 231                 | Kapitale të Trupëzuara       | 80,000         | -40,000         | 40,000         | 31,838         | 8,162          | 80%        |
| <b>Nen - Totali</b> | <b>Shpenzime Kapitale</b>    | <b>422,365</b> | <b>-117,774</b> | <b>304,591</b> | <b>184,392</b> | <b>120,198</b> | <b>61%</b> |
| <b>Totali</b>       | <b>Korrente dhe Kapitale</b> | <b>510,583</b> | <b>-116,798</b> | <b>393,785</b> | <b>261,238</b> | <b>132,546</b> | <b>66%</b> |

**Shpenzimet kapitale ( zërat 230 +231)** janë planifikuar në vlerën 422,365 mijë lekë, pakësuar gjatë vitit në vlerën 117,775 mijë lekë, buxheti i miratuar është në vlerën 304,591 mijë lekë, realizuar në fakt gjatë vitit 2016 në vlerën 184,393 mijë lekë. Mosrealizimi për vitin 2016 është në vlerën 120,196 mijë lekë.

Me mosrealizim në këtë kategori shpenzimesh paraqitet zëri “Shpenzime kapitale”( 230 +231) me financim të brendshëm, ku buxheti i miratuar është në vlerën 164,590 mijë lekë, realizuar në fakt 53,685 mijë lekë ose me mosrealizim në vlerën 110,905 mijë lekë. Ky zë paraqitet me mosrealizim pasi sipas shkresës së Ministrisë së Financave nr.10739/193 prot, datë 21.11.2016 “Transferim fondesh nga llog 231 në llogarinë 230” shuma prej 34,368 mijë lekë paraqitet në zërin “ Fond i ngrirë” deri në momentin e plotësimit të procedurave të investimeve publike për projektet e reja, po kështu një pjesë e financimit të brendshëm mbartet për vitin tjetër pasi projekti i Ri-inxhinierimit nuk përfundon me vitin ushtrimor.

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme rezulton se: Shpenzimet gjithsej nga 510,583 mijë lekë të planifikuara në fillim të vitit pas shtesave dhe pakësimeve ka pësuar ndryshime duke bërë që buxheti faktik i miratuar për vitin 2016 të jetë në vlerën 393,785 mijë lekë ose në masën 66%.

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim :

- Buxheti final për pagat dhe shtesat është më i lartë për 2,395 mijë lekë në krahasim me atë fillestar. Kjo shtesë është rezultat i rritjes me rishikimin e buxhetit. Realizimi i buxhetit në këtë kategori është 87.5 %.
- Buxheti final për sigurime shoqërore është më i lartë për 2,586 mijë lekë në krahasim me atë fillestar. Kjo shtesë është rezultat i rritjes me rishikimin e buxhetit. Realizimi i buxhetit në këtë kategori është 84 % .
- Buxheti final i mallrave dhe shërbimeve është më i vogël se ai fillestar për 4,005 mijë lekë, kjo si rezultat i rishikimit në buxhet.
- Buxheti final i investimeve kapitale është më i ulët për 117,799 mijë lekë në krahasim me atë fillestar.

**Për vitin 2017** deri në momentin e auditimit buxheti i miratuar nuk ka pësuar ndryshime. Realizimi i shpenzimeve për vitin 2017( 6- mujori i parë) paraqitet si më poshtë në 000/lekë.



| Artikulli           | Emertimi                     | Plan 2016      | Buxheti vjetor, shtesa e pakesime | Buxheti vjetor final | Fakti 2016     | Fakti ne % |
|---------------------|------------------------------|----------------|-----------------------------------|----------------------|----------------|------------|
| 600                 | Paga                         | 101,107        | 0                                 | 101,107              | 79,375         | 79%        |
| 601                 | Sigurime Shoqërore           | 21,673         | 0                                 | 21,673               | 8,821          | 41%        |
| 602                 | Mallra dhe Shërbime          | 20,000         | 0                                 | 20,000               | 7,068          | 35%        |
| <b>Nen-Totali</b>   | <b>Shpenzime Korrente</b>    | <b>142,780</b> | <b>0</b>                          | <b>142,780</b>       | <b>95,265</b>  | <b>67%</b> |
| 230                 | Kapitale të Patrupëzuara     | 84,441         | 0                                 | 84,441               | 0              | 0%         |
| 231                 | Kapitale të Trupëzuara       | 92,000         | 0                                 | 92,000               | 44,324         | 48%        |
| 230                 | Kapitale të Patrupëzuara     | 70,000         | 0                                 | 70,000               | 50,703         | 72%        |
| 231                 | Kapitale të Trupëzuara       | 60,000         | 0                                 | 60,000               | 32,865         | 55%        |
| <b>Nen - Totali</b> | <b>Shpenzime Kapitale</b>    | <b>306,441</b> | <b>0</b>                          | <b>306,441</b>       | <b>127,893</b> | <b>42%</b> |
| <b>Totali</b>       | <b>Korrente dhe Kapitale</b> | <b>449,221</b> | <b>0</b>                          | <b>449,221</b>       | <b>223,157</b> | <b>50%</b> |

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme për 6- mujorin e parë të vitit 2017 rezultojnë se: Shpenzimet gjithsej nga 449,221 mijë lekë të planifikuar për gjithë vitin janë realizuar në vlerën 223,156 mijë lekë ose në masën 50 % të totalit të planifikuar.

Shpenzimet për artikullin “Paga e sigurime” zënë 40 % të totalit të shpenzimeve dhe janë realizuar në masën 72 % në krahasim me planin.

Shpenzimet për artikullin “Mallra dhe shërbime 602” zënë 3,2 % të totalit të shpenzimeve dhe janë realizuar në masën 35 % në krahasim me planin.

Shpenzimet për artikullin “Shpenzime kapitale” zënë 57 % të totalit të shpenzimeve dhe janë realizuar në masën 42 % në krahasim me planin.

Sipas këtyre të dhënave totali i realizimit të buxhetit të planifikuar është në masën 50 % të totalit të përgjithshëm. Ecuria e realizimit të buxhetit për këtë periudhë paraqitet e mirë duke ju referuar totalit të shpenzimeve të realizuara në krahasim me ato të planifikuara për vitin 2017.

#### **Lidhur me analizën e realizimit të buxhetit për periudhën e audituar për vitin 2016 rezultoi se:**

Nga GMS dhe Ekipi i Menaxhimit të Programit është përgatitur Raporti i Monitorimit për 6-mujorin e parë dhe është dërguar në Ministrinë e Financës dhe Ministrinë e Inovacionit me shkresën nr.855, datë 28.07.2016 “Mbi performancën financiare buxhetore të ADISA për periudhën 6-mujore”.

Për periudhën 9-mujore nga Ekipi i Menaxhimit të Projektit është përgatitur Raporti I monitorimit i cili është dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Inovacionit me shkresën nr.1205 prot, datë 28.10.2016 “ Mbi performancën financiare buxhetore të ADISA për 9- mujorin”.



Për periudhën 12- mujore nga Ekipi i Menaxhimit të Projektit është përgatitur Raporti i Monitorimit dhe është dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Inovacionit me shkresën nr.87 prot, datë 30.01.2017 “Mbi performancën financiare buxhetore të ADISA për 12- mujorin e vitit 2016.

**Për vitin 2017** Raporti i Monitorimit është dërguar në Ministrinë e Inovacionit me shkresën nr.644 prot, datë 08.06.2017 “Mbi performancën financiare buxhetore të ADISA” për periudhën Janar – Prill 2017 konformë me ligjin nr.9936/2008 neni 65 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor” i ndryshuar.

### **Gjetje nga auditimi**

*Për vitin 2016 realizimi i buxhetit në nivelin 66 % në krahasim me planin dhe mbetja e fondit në zërin “Fond i ngrirë” tregon për një realizim jo të kënaqshëm të buxhetit të planifikuar.*

*Planifikimi jo i duhur i buxhetit mos hartimi i projekteve për investime etj bën që fondi i akorduar nga qeveria të mbetet në zërin fond i ngrirë duke sjellë mosplotësimin e objektivave për vitin 2016.*

**U rekomandua që për periudhën në vazhdim të kërkohet një detajim më i mirë i shpenzimeve dhe përgatitja e programeve dhe projekteve, me qëllim që fondi i miratuar nga Ministria e Financës të mos ngelet në zërin “Fond i ngrirë” për munges të këtyre projekteve.**

***Lidhur me këtë rekomandim nga nëpunësi përgjegjës u kthye observacion me shkresën nr.790/3 prot, datë 265.10.2017 duke theksuar se:***

*“Masa e realizimit të buxhetit është në masën 51% (Fakti 130 528 853 lekë / plan 255 487 650 lekë) pa përfshire financimin e huaj dhe shkaqet e mosrealizimit janë:*

- A) Në masën 66% ka ardhur nga mosdorëzimi i kontratës të lidhur midis palëve me nr. 572/2 prot., datë 20.01.2016 me objekt “Procesi i ri-inxhinierimit për Qendrën e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara” (ndryshuar me Shtojcë I nr. 245/7 prot, datë 20.10.2016) në shumën 82 440 960 lekë.*
- B) Në masën 12 235 080 lekë ose 10% vjen nga mos lidhja e kontratës së zbatimit të punimeve për Qendrën e Integruar të Shërbimeve Publike në Gjirokastrë.*
- C) Në masën 10 047 765 ose 8% vjen nga diferenca e fondit limit (prokurimet e përqendruara) dhe vlerës së kontraktuar mbas përfundimit të procedurës së prokurimit.*

***Pra nuk dakordësojmë me shkakun e përcaktuar nga Ju: mos planifikimi i duhur dhe mos hartimi i projekteve. Mosrealizimi kryesisht ka ardhur me mos dorëzimin produkteve të***

***kontratës nga subjekti i kontraktuar Deloitte Albania sh.p.k ne masën 66%.***

***Bashkëlidhur rakordimi me Degën e Thesarit”.***

**Koment:** Grupi i auditimit pajtohet me sqarimin e dhënë nga Sektori i Financës lidhur me arsyen e përcaktuar nga grupi i auditimit për mosrealizimin e buxhetit (hartimin e projekteve dhe mbetjen e fondit në zërin Fond i ngrirë) por konstatimi qëndron lidhur me mosrealizimin e buxhetit për vitin 2016. Kështu që gjetja në lidhje me mosrealizimin e buxhetit do të pasqyrohet dhe në raportin final të auditimit , duke lënë si rekomandim një impenjim me të madh në kërkesën e llogarisë për kompanitë ose subjektet e ndryshme me të cilat ADISA ka lidhur kontrata për realizimin e produktit në afatet e përcaktuara për kryerjen e punëve ose shërbimeve.

***3.Administrimi i vlerave materiale në magazinë nëpërmjet mbajtjes e pasqyrimit në kontabilitet si në sasi ashtu dhe në vlerë për periudhën Janar 2016 deri në Qershor 2017. Lëvizja e mallrave dhe materialeve, dokumentimi i lëvizjes së materialeve e mallrave, lëvizja e dalja nga magazina dhe dokumentacioni i përdorur në këtë rast, rakordimi sipas periudhave kohore, evidentimi e saktësimi i inventarizimit në fund të vitit.***

Nga auditimi i bilancit kontabël dhe pasqyrave financiare, për vitin 2016 rezultoi se këto pasqyra janë dërguar në Ministrinë e Financave me shkresën nr.196 prot, datë 28.02.2017 duke respektuar afatet ligjore të përcaktuara.

Sistemi i kontabilitetit në ADISA mbahet me anë të programit Alfa, i cili garanton sigurinë e informacionit dhe është i printueshëm në çdo kohë. Veprimet kontabël janë kryer konform dispozitave ligjore në fuqi , ku çdo regjistrim është bërë në bazë të dokumentave justifikuese, si dhe janë zbatuar parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit

***3.1. Auditim mbi administrimin e vlerave materiale në magazinë nëpërmjet mbajtjes e pasqyrimit në kontabilitet si në sasi ashtu dhe në vlerë.***

Nga auditimi i ditarëve dhe librave kontabël rezultoi se organizimi i kontabilitetit, është në pajtim me kërkesat e ligjit nr.9224, date 24.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar, veprimet janë të rregullta, plani i llogarive ishte përpiluar në përputhje me kërkesat e planit të përgjithshëm kontabël.

Mbajtja e kontabilitetit bëhet në mënyrë të kompjuterizuar. Regjistrimet kontabël janë mbështetur në dokumenta justifikues dhe llogaritë janë të analizuara dhe të rakorduara.

Regjistrimi në kontabilitet i daljeve nga magazina është bërë me çmimin e blerjes dhe amortizimi i tyre llogaritet në fund të vitit ushtrimore.

Regjistrimi në ditarë i hyrje – daljeve të aktiveve.

Për aktivet e blera janë debituar llogaritë e klasës 2 ( 231,218) në kredi të klasës 4 (401) , me ndërmjetësimin e llogarisë 231 është kredituar llogaria 218 , në kredi të llogarisë 231 për vlerën e aktiveve të qëndrueshme të bëra hyrje. Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme në fund të vitit ushtrimore është paraqitur me vlerën neto.

Mënyra e mbajtjes së inventarit është sipas inventarit kontabël të përhershëm që mundëson njohjen në kohë gjatë ushtrimit të gjendjeve ekzistuese të sasisë dhe në vlerë për çdo artikull. Llogaria 312,327 kanë funksionuar si llogari magazinë ku përveç gjendjes në çelje të ushtrimit, këto llogari regjistrojnë sistematikisht gjatë gjithë ushtrimit cdo lëvizje (hyrje – dalje) të ndodhur.

Për hyrjet nga blerjet gjatë ushtrimit këto llogari janë debituar në kredi të llogarisë 602 regjistrim i njëkohshëm me atë në debit e llogarive të blerjeve klasa 6 dhe kredi të llogarisë 401 furnitor.

Për daljet gjatë vitit ushtrimor llogaritë e gjendjes së inventarit janë kredituar në debit e llogarisë 602.

Amortizimi është llogaritur në zbatim të Udhëzimit nr.5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar duke përdorur normat e amortizimit të përcaktuara nga ky udhëzim.

Sipas pasqyrave të bilancit me datë 31.12.2016 ADISA ka një vlerë neto aktivesh të qëndrueshme (inventarë ekonomik) prej 106,645,361 lekë, me një amortizim vjetor të akumuluar prej 3,730,128 lekë. Në fund të vitit ushtrimor nuk janë bërë dalje nga përdorimi të aktiveve.

Në lidhje me dokumentimin e lëvizjes së mallrave e materialeve (hyrje-daljet), dokumentacionin e përdorur në këtë rast, funksionimi i urdhër furnizimit etj, u auditua zbatimi i procedurave ligjore për lëvizjen e mallrave dhe materialeve nga magazina si për hyrjet dhe për daljet dhe rezultoi se:

Hyrja e mallrave në magazinë dokumentohet me fletë hyrje e hartuar sipas gjendjes fizike të mallrave dhe materialeve. Për blerjet me procedura tenderimi hyrjet janë bërë sipas kontratave të furnizimit duke i bashkëngjitur nga sektori i financës gjithë dokumentacionin autorizues. Pritja dhe verifikimi i mallrave është bërë nga komisionet e ngritura sipas urdhërave nga Titullari i Institucionit. Daljet nga magazina janë dokumentuar me fletëdalje të shoqëruar me urdhër dorëzimi të plotësuar nga Përgjegjësi i Sektorit të Shërbimeve bazuar në kërkesat sipas sektorëve. Për aktivet e dala për përdorim të punonjësve janë plotësuar kartelat personale për cdo punonjës.

#### **Në përfundim të auditimit u konstatua se :**

**1.-** Asetet (ndërtesat) e marra në përgjegjësi administrimi në qytetet Krujë, Fier dhe ZVRPP Tiranë nuk janë regjistruar në regjistrin e aktiveve të ADISA.

**1.1-** Me VKM nr.385, datë 25.05.2016 ka kaluar në përgjegjësi administrimi ADISA-s, ndërtesa në Krujë Kati i parë i objektit 2 katësh “Ndërmarrje e Qëndristarisë Krujë” e ndodhur në zonën kadastrale nr. 8621 me sipërfaqe 330,2 m2 dhe është regjistruar në pronësi të ADISA sipas regjistrit hipotekorë nr.97, datë 17.03.2017. Me urdhër nr.583/1, datë 24.11.2016 është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim të këtij objekti i përbërë nga 3 antarë. Nga ky komision është hartuar procesverbali i marrjes në dorëzim, nr.583/3 prot, datë 24.11.2016 në prani dhe të komisionit të Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës ku pas verifikimit është konstatuar se godina është në përputhje me përshkrimin dhe sipërfaqen e përcaktuar në VKM dhe bazuar në këtë

konstatim është bërë marrja në dorëzim dhe kalimi në përgjegjësi administrimi i kësaj ndërtese nga Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës te ADISA.

**1.2** - Me VKM nr.306, datë 20.04.2016 ka kaluar në përgjegjësi administrimi nga Ministria e Punëve të Brendshme te ADISA Ndërtesa në qytetin e Fierit (ZVRPP Fier) sipas Certifikatës për Vërtetim Pronësie nr.1333249 të lëshuar më datë 21.12.2016, e cila ndodhet në zonën kadastrale nr.8531 me sipërfaqe 396 m<sup>2</sup>, me numër pasurie 6/6-ND2/1 dhe është regjistruar në pronësi të ADISA. Me urdhër nr.435/2 prot, datë 17/11/2016 është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim të këtij objekti I përbërë nga 3 anëtarë. Nga ky komision është hartuar procesverbali me nr.435/3 prot, datë 06.12.2016 në prani dhe të komisionit të ngritur nga Ministria e Punëve të Brendshme ku pas verifikimit është konstatuar se godina është në përputhje me përshkrimin dhe sipërfaqen e përcaktuar në VKM dhe bazuar në këtë konstatim është bërë marrja në dorëzim dhe kalimi në përgjegjësi administrimi i kësaj ndërtese nga Ministria e Punëve të Brendshme te ADISA.

**1.3** - Me VKM nr.650, datë 28.09.2016 për kalimin në përgjegjësi administrimi nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve tek ADISA të mjediseve të katit të parë të ndërtesës me emërtim “Shtëpia e Ushtarakëve” Gjirokastrë, me sipërfaqe 412 m<sup>2</sup>. Me urdhër nr.1046/10 prot, datë 26.10.2016 është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim të këtij objekti i përbërë nga 3 anëtarë. Nga ky komision është hartuar procesverbali me nr.1046/11 prot, datë 28.10.2016 në prani të komisionit të ngritur nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve ku pas verifikimit është konstatuar se godina është në përputhje me përshkrimin dhe sipërfaqen e përcaktuar në VKM dhe bazuar në këtë konstatim është bërë marrja në dorëzim dhe kalimi në përgjegjësi administrimi i kësaj ndërtese nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve te ADISA. Nga ADISA ka nisur procedura e regjistrimit në hipoteke të këtij objekti dhe deri në momentin e auditimit kjo procedurë është në process.

***3.2 Mbi zbatimin e ligjshmërisë në kryerjen e inventareve periodik e vjetorë të mallrave në magazinë e në institucion, mallrat me qarkullim të ngadalshëm apo stok të krijuar dhe puna për uljen e tyre, nxjerrja e mallrave apo materialeve jashtë përdorimit.***

Me Urdhërin nr.1042 prot, datë 13.12.2016 “Për kryerjen e inventarizimit të aseteve (aktiveve afatgjata materiale dhe aktiveve afatshkurtra)” është ngritur komisioni i inventarizimit i përbërë nga 5 (pesë) antarë. Inventarizimi është kryer në magazinën e ADISA, në Zyrën Vendore Tiranë dhe Zyrën Vendore Kavajë. Mbi bazën e inventarëve analitikë janë përpiluar inventarët sintetik si shuma e tyre të detajuar sipas llogarive inventariale.

Në përfundim të inventarizimit nga ky komision është hartuar raporti përmbledhës duke pasqyruar gjendjen e llogarive në fund të vitit, gjithashtu në përfundim të inventarizimit nuk rezultuan mallra me qarkullim të ngadalshëm, nuk kishte stoqe të krijuara kështu që nuk ishin nxjerrë jashtë përdorimit mallra apo materiale.

**Gjetje nga auditimi**

- *Nga grupi i auditimit u vu re se hyrje-daljet në magazinë nuk dokumentohen menjëherë, kështu që dhe dorëzimi tek nëpunësi përgjegjës për financat kryhet me vonësë.*

- *Regjistrimi i veprimeve në librat kontabël nuk është kryer në mënyrë sistematike dhe kronologjike, regjistrimi është kryer me shumë vonesë.*
- *Sektori i Financës nuk ka patur impenjimin e duhur për marrjen e këtij dokumentacioni dhe regjistrimin në librat kontabël duke bërë që:  
Këto dokumenta të mos kontrollohen nga financa për rregullshmërinë e tyre si nga ana e plotësimit të të dhënave që kërkon ky dokument po ashtu dhe kontrollin e veprimeve aritmetike, si dhe moskryerjen e rakordimeve periodike me magazinën dhe mos përcaktimin e gjendjes faktike në çdo kohë të artikujve në magazinë.*
- *Nga auditimi i dosjes se inventarizimit nga grupi i auditimit u konstatua se gjendja kontabël e aktiveve afatgjata pasqyruar në pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2016, nuk përputhet me gjendjen fizike të këtyre aktiveve sipas kartelave të inventarizimit të kryer në fund të vitit në shumën 127.680 lekë, e detajuar sipas tabelës:*

| <i>Llogaria</i> | <i>Emërtimi</i>          | <i>Vlera kontabël sipas bilancit</i> | <i>Vlera nga inventarizimi fizik</i> | <i>Diferenca fizik/bilanc</i> |
|-----------------|--------------------------|--------------------------------------|--------------------------------------|-------------------------------|
| <i>21</i>       | <i>Aktive afatgjata</i>  | <i>91,448,234</i>                    | <i>Në kontabilitet 91,575,914</i>    | <i>+ 127,680</i>              |
|                 |                          |                                      | <i>Në përdorim 20,013,119</i>        | <i>-</i>                      |
| <i>31</i>       | <i>Materiale konsumi</i> | <i>6,160,318</i>                     | <i>6,160,318</i>                     | <i>-</i>                      |
| <i>32</i>       | <i>Inventar i imët</i>   | <i>1,064,568</i>                     | <i>1,064,568</i>                     | <i>-</i>                      |

- *Për inventarin individual (kompjuter, printer, tavolina etj) për çdo punonjës janë çelur kartelat individuale por nuk azhornohen rast pas rasti me dorëzimet dhe marrjen në dorëzëm të inventarit në ngarkim.*
- *Në kartelat e magazinës të plotësuara nga komisioni i inventarizimit, automjetet e institucionit janë evidentuar si aktive gjendje në magazinë.*
- *Aseteve (ndërtesave) të marra në përgjegjësi administrimi në qytetet Krujë, Fier dhe ZVRPP Tiranë nuk janë regjistruar në regjistrin e aktiveve të ADISA.*
- *Komisioni i ngritur për marrjen në dorëzim të objekteve në qytetet Krujë dhe Fier nuk ka tërhequr nga Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës dhe Ministria e Punëve të Brendshme kartelën shoqëruese të inventarit të ndërtesës që duhet të përmbajë (Vlerën fillestarë të ndërtesës, rikonstruksionet e kryera ndër vite, amortizimin si dhe vlerën e mbetur, më qëllim që këto dokumenta ti dorëzohen Sektorit të Financës për veprime të mëtejshme.*
- *Vlera prej 18,927,255 lekë rikonstruksion i ndërtesës në Krujë është regjistruar në llogarinë 213 “Ndërtime e Rikonstruksione”, megjithëse ndërtesa ku është bërë rikonstruksioni nuk është regjistruar në Regjistrin e AQT të ADISA-s.*
- *Për evidentimin e aktiveve dhe lëvizjen e tyre është çelur dhe azhornuar regjistri i aktiveve, por ky regjister nuk është i hartuar sipas përcaktimeve në Udhëzimin nr.30 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Neni 3 “Rregjistrimi i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, pika 30 .*

U rekomandua që për periudhën në vazhdim:

- Të merren masa për paisjen me dokumentacionin e nevojshëm nga institucionet që janë marrë në dorëzim objektet (Vlerën fillestare të ndërtesës, rikonstruksionet e kryera ndër vite, amortizimin si dhe vlerën e mbetur të tyre) me qëllim që këto aktive të regjistrohen në regjistrin e aktiveve gjatë vitit ushtrimorë 2017.
- Të bëhet sistemimi i llogarisë 212 ‘Ndërtime e rikonstruksione’ në llogarinë 231 “Shpenzime në Proçess për Rritjen e AQT” për vlerën 18,927,255 lekë (Krujë) deri në momentin që të regjistrohet në kontabilitet dhe vlera e ndërtesës ku është bërë ky rikonstruksion.
- Për periudhën në vazhdim Drejtoria e Financës dhe Administrimit të të ardhurave të marrë masa për sistemimin e llogarisë së aktiveve në vlerën 127,680 lekë ( për mos kuadrumin me gjendjen fizike të kësaj llogarie) duke kryer sipas procedurave standarte ligjore inventarizimin fizik të aktiveve të institucionit dhe në rastet kur konstatohen teprica ose mungesa të kryhen sistemimet e duhura në kontabilitet.
- Për përmirësimin e punës në të ardhmen nga Sektori i Financës të ushtrohen kontrole të vazhdueshme mbi dokumentacionin e mbajtur për evidentimin dhe lëvizjen e mallrave e materialeve në magazinë, nga magazinieri plotësimi i dokumentave të magazinës të bëhet në çast duke evidentuar hyrje - daljet brenda ditës. Regjistrimi në kontabilitet të kryhet në mënyrë sistematike dhe kronologjike, duke evidentuar mallrat dhe materialet e bëra hyrje - dalje të plotësohen kartelat për çdo mall dhe të kryhen rakordimet periodike me magazinën.
- Për Automjetet në pronësi të ADISA të cilat janë evidentuar si aktive gjendje në magazinë (megjithëse përdoren për kryerjen e shërbimeve të ndryshme në funksion të institucionit) të priten fletëdaljet dhe sipas drejtorive të përcaktohen personat përgjegjës dhe të evidentohen në kartelën personale të çdo punonjësi që e mer në ngarkim, me qëllim ndjekjen dhe administrimin e karburantit dhe shpenzimeve të tjera që kryhet për çdo automjet.
- Të përmirësohet regjistri i aktiveve i cili duhet të përmbajë të dhënat sipas Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kapitulli nr.3 “Regjistrimi i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, pika 30, duke përfshirë në këtë regjistër dhe ndërtesat që ADISA ka në administrim.
- Të kryhet azhurnimi rast pas rasti i kartelave individuale për çdo dorëzim dhe marrje në dorëzim të inventarit individual ( printër, kompjuter etj) të çdo punonjësi.

*Lidhur me këto gjetje nga nëpunësi përgjegjës u kthye observacion me shkresën nr.790/3, prot, datë 25.10.2017 lidhur me:*

1- Regjistrimet me vonesë në kontabilitet të dokumantave të magazinës, impenjimin e këtij sektori për marrjen, kontrollin dhe regjistrimin e tyre si dhe azhurnimin e kartelave individuale si dhe evidentimin e lëvizjeve të aktiveve për vitin 2016 duke theksuar se:

- “Deri me 13.09.2016 kontabiliteti është mbajtur në excel dhe nga muaji Tetor dhe deri më sot janë hedhur tre vite bashkë 2015, 2016, 2017 në programin Alfa. Pra kanë qenë regjistruar dhe u ri-regjistruan mbas instalimit të programit Alfa Platiniun. (bashkëlidhur akti i marrjes në dorëzimit).

- Në lidhje me cilësinë, kohën e përgatitjes së dokumentacionit të magazinës është evidentuar nga sektori i financës dhe për këtë është përgatitur memo nr.720 prot, datë 23.06.2017 dhe urdhri përkatës nr.720/1, datë 23.06.2017.

- Lidhur me konstatimin për azhurnimin e kartelave individuale si dhe evidentimin e lëvizjeve të aktiveve për vitin 2016, konstatimi është i saktë. Aktualisht, Sektori i Shërbimeve Mbështetëse po plotëson të gjitha procesverbalet e lëvizjeve të aktiveve dhe një kopje e tyre dorëzohet në Sektorin e Financës për përditësim të kartelave individuale”.

**Koment:** Ky observacion nuk është marrë parasysh nga ana Jonë, pasi konstatimet qëndrojnë dhe observacioni është vetëm i natyrës justifikuese.

**2- Gjetjen mbi llogarinë e përdorur për regjistrimin kontabël të investimit për rikonstruksionin e Qendrës së Integruar të Shërbimeve Publike Krujë duke theksuar se:**

Nuk dakordësojmë pasi regjistrimi është bërë në llogarinë ekonomike 212 (Ndërtim e rikonstruksione) dhe jo në atë 213.

Për llogarinë e sugjeruar 231 (Shpenzime në proces për rritjen e AQT) nuk dakordësojmë pasi në vlerësimin tonë dhe referuar Udhëzimit nr. 14, datë 28.12.2006 citojmë definicionin e përdorimit të llogarisë 231:

“Grupi i llogarive 23 “Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme) për aktivet që janë blerë e krijuar, të përfunduara e të marra në dorëzim për të cilat kryhet veprimi kredi llogaritë Qëndrueshme”.

“Për investimet e ndërtuara për të tretë të përfunduara dhe të dorëzuara, të bëhet veprimi në debi të llogarive të grupit 14 “Grante për pjesëmarrje për investime për të tretë” me kundër parti kreditin e llogarive të grupit 23”AQ në proces”.

Nga sa më sipër, jemi në rastin e investimit të përfunduar e të marrë në dorëzim, jo në investim përkatës të grupit 23 me kundër parti debitin e llogarive të grupit 20 e 21 të Aktiveve të në proces”.



**Koment :** Grupi i auditimit nuk pajtohet me sqarimin e dhënë duke theksuar se deri në momentin e regjistrimit në kontabilitet të ndërtesave të dhëna në përgjegjësi administrimi, ky investim të mbahet në llogarinë 23 “AQT në process” , në momentin e regjistrimit në kontabilitet dhe në pasqyrat financiare të ADISA ky investim të kalojë në llogarinë 212 duke ia shtuar këtë vlerës së ndërtesës.

**3. Në lidhje me gjetjen nga auditimi mbi marrjen e regjistrit të aktiveve dhe regjistrimin në kontabilitet të ndërtesave të marra në përgjegjësi administrimi në observacion theksohet se:**

“Sa citohet në lidhje me godinat e marra në administrim, konstatimi është i drejtë. Janë marrë masat në vitin 2017 dhe janë nisur shkresat për marrjen e vlerave respektive kontabël nga institucionet që i kanë pasur në administrim”.

*Pas verifikimit të kryer grupi i auditimit konstatoi se me shkresën nr.1071 prot, datë 27.10.2017 Drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë, shkresën nr.1070, datë 27.10.2017 drejtuar Bashkisë Kavajë, shkresën nr.1069, datë 27.10.2017 drejtuar Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë Tiranë dhe Ministrisë së Mbrojtjes, shkresës nr.1068 prot, datë 27.10.2017 drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe shkresën nr.1067 prot, datë 27.10.2017 drejtuar Ministrisë së Mbrojtjes “Për vënien në dispozicion të regjistrit të aktiveve “Ndërtesa” dhe çrregjistrimin e këtyre aktiveve”, i është kërkuar këtyre institucioneve vënia në dispozicion të regjistrit të aktiveve.*

**Koment:** Rekomandimi i dhënë nga grupi i auditimit është marrë në shqyrtim nga Menaxhimi dhe ka filluar zbatimi i tij, opiniononi i auditit mbetet i pandryshuar, deri në momentin e realizimit të këtij rekomandimi kështu që kjo gjetje do të pasqyrohet dhe në Raportin Final të Angazhimit. Referuar gjetjeve të tjera të cituara në pikën 3.2 të projekt raportit nga nëpunësi përgjegjës nuk është kthyer observacion, kështu që këto gjetje merren të mirëqena dhe pasqyrohen dhe në Raportin Final të Angazhimit.

**4. Mbi ndjekjen e realizimin e shpenzimeve për pagat, sigurimet shoqërore, blerje karburant, mallra e materiale, shpenzime për udhëtim e dieta brenda e jashtë vendit, shpenzime të tjera, dokumentimi i këtyre shpenzimeve në përputhje me treguesit e programit ekonomik dhe problemet që kanë dalë në këtë drejtim.**

Nga auditimi i të dhënave të vëna në dispozicion nga Sektori i Financës u konstatua se:

**Për vitin 2016 fondi i përgjithshëm i pagave, i sigurimeve shoqërore, shëndetësore** është realizuar për numrin faktik të punonjësve 90 punonjës, nga 117 punonjës të miratuar. Struktura e re organike për vitin 2016 është miratuar me shkresën nr.654, datë 14.09.2016 të Kshillit të Ministrave "Për miratimin e strukture dhe të organikes së ADISA", ndërkohë që shtesa e fondit të pagave ka ardhur si rezultat i ndryshimeve në buxhet.

**Fondi i pagave për vitin 2016** është planifikuar 57,000 mijë lekë shtuar 2,395 mijë lekë buxheti vjetorë i miratuar 59,395 mijë lekë, realizuar në fakt 51,954 mijë lekë ose në masën 85 % të fondit të miratuar për paga. **Mosrealizimi i fondit të pagave për vitin 2016 është në vlerën 7,441 mijë lekë.**

**Fondi për sigurime shoqërore** është planifikuar në shumën 7,600 mijë lekë, shtuar me 2,586 mijë lekë, buxheti i miratuar 10,186 mijë lekë realizuar në fakti 8,554 mijë lekë ose në masën 84 % të fondit për sigurime. **Mosrealizimi për vitin 2016 është në vlerën 1,632 mijë lekë.**

#### **Për vitin 2017 (6- mujori i parë).**

**Fondi i përgjithshëm i pagave**, i sigurimeve shoqërore, shëndetësore është realizuar për numrin faktik të punonjësve 122 punonjës, nga 122 punonjës të miratuar sipas VKM nr.654, datë 14.09.2016 deri në muajin mars 2017. Struktura e re organike për vitin 2017 është miratuar me VKM nr.306, datë 05.04 2017 “Për disa ndryshime në Vendimin nr.654, datë 14.09. 2016” ku janë miratuar 160 punonjës.

**Fondi i pagave për vitin 2017** është planifikuar në vlerën 101,107 mijë lekë, buxheti i miratuar në vlerën 101,107 mijë lekë , realizuar në fakt për periudhën Janar – Qershor 2017 në vlerën 79,375 mijë lekë ose 79 % të fondit të miratuar për paga.

**Fondi për sigurime shoqërore** është planifikuar në vlerën 21,673 mijë lekë, buxheti i miratuar në vlerën 21,673 mijë lekë, realizuar në fakt në vlerën 8,821 mijë lekë ose 41 % të fondit për sigurime.

| Emërtimi                   | Viti 2016 |        |    | Viti 2017 |        |    |
|----------------------------|-----------|--------|----|-----------|--------|----|
|                            | Plan      | Fakt   | %  | Plan      | Fakt   | %  |
| <b>Paga (600)</b>          | 59,395    | 51,954 | 85 | 101,107   | 79,375 | 79 |
| <b>Sig.Shoqërore (601)</b> | 10,186    | 8,554  | 84 | 21,673    | 8,821  | 41 |

- Me urdhër nr.1292,datë 11.11.2016 “Për kryerjen e orëve shtesë të punës” nga Titullari i Institucionit është urdhëruar kryerja e orëve shtesë për punonjësit që punojnë në sportelet e ADISA në ZVRPP Tiranë si rezultat i procesit të rivlerësimit të pasurive të paluajtshme cdo ditë të shtunë nga ora 8.00 – 14.00.

- Bazuar në MEMO-n e Drejtorit të Drejtorisë së Zhvillimit dhe Monitorimit të Standarteve nr.457 prot, datë 26.04.2017 “Për angazhimin e stafit të ZVRPP Tiranë dhe një pjesë të stafit të Zyrës Qëndrore të ADISA”, nga Titullari i Institucioni është nxjerrë Urdhëri nr.457/1 prot, datë 26.04.2017 “Për kryerjen e orëve shtesë të punës” dhe pagesën e tyre.

- Bazuar në MEMO-n nr.584 prot, datë 26.05.2017 “Kërkesë për angazhimin e Stafit të Zyrave Rajonale ADISA në Kavajë, Krujë e Fier më datë 27.05.2017” të Drejtorit të Drejtorisë së Zhvillimit të Monitorimit të Standarteve, nga Titullari i Institucionit ka dalë urdhëri nr.584/1, datë 26.05.2017 “Për kryerjen e orëve shtesë të punës” për punonjësit e këtyre zyrave.

- Në zbatim të këtyre urdhërave nga Sektori i Financës janë kryer pagesat sipas Urdhër Shpenzime nr.128, datë 01.12.2016 në vlerë 53,087 lekë, U.Sh nr.2 datë 01.01.2017 në vlerë 57,177 lekë, U.Sh nr.19, datë 01.02.2017 në vlerë 76,744 lekë, U.Sh nr.31, datë 01.03 2017 në vlerë 68,218 lekë, U.Sh nr.59, datë 03.04.2017 në vlerë 74,367 lekë, U.Sh nr.84, datë 02.05 2017

në vlerë 98,196 lekë, U.Sh nr.116, datë 01.06.2017 me vleftë 142,610 lekë dhe U.Sh nr.147, nr.148 datë 03.07.2017 në vlerën 590,785 lekë.

Totali i shpenzimeve për orë shtesë jashtë orarit zyrtarë të paguara për periudhën Nëntor 2016 deri më Korrik 2017 është në **vlerën 1,161,184 lekë**.

#### ***Gjetje nga auditimi***

- ***Urdhëri nr.1292, prot, datë 11.11.2016 “Për kryerjen e orëve shtesë të punës” ka dalë pa një kërkesë nga Drejtoria e Zhvillimit dhe Monitorimit të Standarteve ose ndonjë drejtori tjetër.***
- ***Në urdhërat e cituar më sipër në pikën 3 të tyre, i është kërkuar Sektorit të Financës pagesa e këtyre orëve për shkak se ka shumë fluks të aplikimeve në sportel, kërkesë e cila duhej të kryhej në fund të mbarimit të afatit sipas VKM (brenda 2 muajve nga kryerja e orëve shtesë) nga përgjegjësit e këtyre zyrave ose Drejtori i Drejtorisë së zhvillimit dhe Monitorimit të Standarteve.***
- ***Bazuar në Urdhërat Nr.1292 prot, datë 11.11.2016, nr.457/1 prot, datë 26.04.2015, nr.581/1 prot, datë 26.05.2017 nga Sektori i Financës janë kryer pagesa për orët shtesë jashtë orarit zyrtarë duke shkaktuar ADISA një dëm ekonomik në shumën 1,161,184 lekë. Pagesat e kryera dhe punonjësit të cilët kanë përfituar këtë pagesë paraqiten të detajuar në pasqyrat nga nr.1 deri në nr.8 si pjesë përbërëse e këtij Projektraporti.***

**Të gjitha këto veprime bien në kundërshtim me VKM nr.511, datë 24.06.2002 “Për kohëzgjatjen e punës dhe pushimit në institucionet shtetërore” i ndryshuar me VKM nr.463, datë 16.06.2011 dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.16 datë 20.07.2011 “Mbi zbatimin e vendimit nr.16, datë 20.07.2011 të Këshillit të Ministrave”.**

**U rekomandua që për periudhën në vazhdim Sektori i Financës të marrë masa për arkëtimin e shumave të përfituara në kundërshtim me VKM nr.511, datë 24.06.2002 i ndryshuar sipas të dhënave të paraqitura në pasqyrat nga nr.1 deri në nr.8 bashkëngjitur këtij projektraporti.**

**Të nxirren personat përgjegjës për kryerjen e pagesave në kundërshtim me VKM nr.511, datë 24.06.2002 “Për kohëzgjatjen e punës dhe pushimit në institucionet shtetërore” ,i ndryshuar.**

***Nga nëpunësi përgjegjës u kthye observacion lidhur me këtë gjetje duke theksuar se:***

*“Sektori i Financës ka zbatuar Urdhrat e cituar në projekt raportin e angazhimit. Nga ana Juaj nuk janë dhënë argumentet se përse jemi para rastit të dëmit ekonomik, për sa kohë stafi i ADISA-ës ka punuar jashtë kohës normale të punës referuar listë prezencave respektive.*

*Mbështetur në Udhëzimin nr.16 datë 20.07.2011, “Mbi zbatimin e Vendimit nr. 463, date 16.06.2011 të Këshillit të Ministrave” pika 3 e tij,*

*“Nëpunësi dhe punonjësi i administratës që kryen **veprimtari operacionale**, si rregull, kompensohet me orë/ditë pushimi. Mund të kompensohen financiarisht punonjësit që kryejnë veprimtari të drejtpërdrejtë operacionale vetëm kur plotësohen dy kushtet e mëposhtme:*

*a) kur është e pamundur dhënia e pushimit për orët shtesë të punuara, për shkak të natyrës së veprimtarisë operacionale, ndërprerja e së cilës cenon funksionalitetin e institucionit,*

*b) kur institucioni ka fonde të miratuara për këtë qëllim në buxhetin vjetor të tij.”*

*nga institucioni ka qenë e pamundur të jepej pushim pasi do rezultonte në mbyllje të sporteleve pritëse dhe mosdhënie të shërbimit qytetarëve.*

*Gjithashtu theksojmë se **pagesa e këtyre orëve jashtë kohës normale të punës është mbuluar nga buxheti i miratuar në fillim të vitit për zërin paga dhe sigurime shoqërore.***

*Nga rillogaritja jonë rezulton që në total pagesa për orët jashtë kohës normale të punës është në vlerën **1,155,734 lekë**”.*

Grupi i Auditimit nuk pajtohet me sqarimin e dhënë nga nëpunësi përgjegjës në observacion lidhur me zbatimin e urdhërave të cituar në projekt raport, pasi në mbështetje dhe në zbatim të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, neni 13 “Dokumentimi dhe raportimi i urdhërave të kundërshtuar”, pika 1/ a,c, theksohet se Urdhëri gojore ose i shkruar i Nëpunësit Autorizues kundërshtohet nga Nëpunësi Zbatues në rast se:

a) bie ndesh me dispozitat ligjore në fuqi.

c) Urdhëri për pagesën përfundimtare jepet pa u përfunduar shërbimi .....”.

**Koment:** Ky observacion nuk është marrë parasysh nga ana Jonë, pasi konstatimet qëndrojnë dhe observacioni është vetëm i natyrës Justifikuese. Lidhur me vlerën në total të pagesave për orët shtesë jashtë orarit zyrtarë të punës theksojmë se të dhënat dhe pasqyrat e paraqitura na janë vënë në dispozicion nga sektori i financës megjithatë auditi e merr në konsideratë këtë observacion duke pasqyruar ndryshimet sipas punonjësve dhe shumave përkatëse për shumën 5,445 lekë pasqyruar në pasqyrën përfundimtare nr.1 si pjesë përbërëse e këtij raporti.

**Realizimi i shpenzimeve operative (buxheti i miratuar dhe i akorduar për vitin 2016).**

Shpenzime operative për vitin 2016 janë planifikuar 23,618 mijë lekë paksuar gjatë vitit 4,005 mijë lekë, buxheti i miratuar 19,613 mijë lekë, realizuar në fakt 16,338 mijë lekë.

Mosrealizimi i shpenzimeve operative (mallra dhe shërbime ) paraqitet në vlerën 3,275 mijë lekë.

Shpenzimet operative për vitin 2016 sipas zërave paraqiten në tabelë:

000/lekë

| Nr | Emërtimi                     | Plan ( pa tvsh) | Fakt (me tvsh) | Plan/fakt në % |
|----|------------------------------|-----------------|----------------|----------------|
| 1  | Shpenzime Karburanti         | 240             | 287            | 100            |
| 2  | Shpenzime Udhëtime e dieta   | 2,320           | 2,110          | 91             |
| 3  | Shpenzime Kanceleri + tonera | 9,767           | 6,647          | 68             |
| 4  | Shpenzime Energji + ujë      | 520             | 1,128          | 217            |
| 5  | Shpenzime Ruajtje fizike     | 3,543           | 2,084          | 59             |
| 6  | Shpenzime Materiale pastrimi | 3,187           | 2,600          | 82             |
| 7  | Shpenzime të tjera           | 36              | 1,482          |                |
|    | <b>Totali</b>                | <b>19,613</b>   | <b>16,338</b>  | <b>83.3</b>    |

Siç shihet nga tabela kemi një mosrealizim në zërin “shpenzime për ruajtjen fizike të ambjenteve” në administrim të ADISA në vlerën 3,120 mijë lekë, por ky mosrealizim në vlerë dhe në % vjen pasi vlera e kontratës së lidhur me firmën fituesë është më pak se planifikimi. Në zërin “Shpënzime për energji” kemi një tejkalim të shpenzimeve në vlerën 629 mijë lekë i ardhur si rezultat i likujdimit të energjisë së shpenzuar të akumuluar në vite, por të pafaturuar deri në momentin e lidhjes së kontratës dhe vendosjes së matësit të energjisë nga ana e OSHEE-së.

***Realizimi i shpenzimeve operative (mallra dhe shërbime, buxheti i miratuar dhe i akorduar) për 6- mujorin e parë të vitit 2017.***

Shpenzime operative për vitin 2017 janë planifikuar 20,000 mijë lekë, buxheti i miratuar 20,000 mijë lekë, realizuar në fakt gjatë 6-mujorit të parë të këtij viti në vlerën 7,068 mijë lekë ose 35 % të fondit për mallra dhe shërbime.

Shpenzimet operative për vitin 2017 sipas zërave paraqiten në tabelë:

000/lekë

| Nr | Emërtimi                     | Plan ( pa tvsh) | Fakt (me tvsh) | Plan/fakt në % |
|----|------------------------------|-----------------|----------------|----------------|
| 1  | Shpenzime Karburant          | 623             | 623            | 100            |
| 2  | Shpenzime Udhëtime e dieta   | 2,582           | 668            | 26             |
| 3  | Shpenzime Kanceleri + tonera | 8,053           | 621            | 8              |
| 4  | Shpenzime Energji + ujë      | 1,381           | 1,657          | 120            |
| 5  | Shpenzime Ruajtje fizike     | 2,551           | 2,246          | 88             |
| 6  | Shpenzime Material pastrimi  | 3,183           | 0              | 0              |
| 7  | Shpenzime të tjera           | 1,275           | 1,253          | 98             |
|    | <b>Totali</b>                | <b>20,000</b>   | <b>7,068</b>   | <b>35,3</b>    |

Bazuar në të dhënat e tabelës rezulton se :

**Zëri i shpenzimeve për “Blerje kanceleri dhe tonera”** është realizuar në masën 8 % në krahasim me planin. Sipas të dhënave nga Sektori i Financës ky zë paraqitet me mosrealizim pasi për këtë periudhë auditimi janë përdorur artikujt gjendje në magazinë.

**Zëri “Shpenzime Energji + Ujë”** paraqitet me tejkalim në masën 120 % si rezultat i pagesës së energjisë së shpenzuar nga qendrat e reja të hapura në qytetet Fier dhe Gjirokastrë në administrim të ADISA).

**Zëri i shpenzimeve “Udhëtime e dieta”** për këtë periudhë auditimi paraqitet me një realizim prej 26 % në krahasim me planin, në realizimin e këtij zëri bëjnë pjesë vetëm udhëtimet brenda vendit të cilat janë realizuar në masën 67 % në krahasim me planin.

**Shpenzimet kapitale ( zërat 230 +231)** janë planifikuar në vlerën 306,441 mijë lekë, buxheti i miratuar në vlerën 306,441 mijë lekë, realizuar në fakt gjatë 6 mujorit të vitit 2017 në vlerën **127,893** mijë lekë ose 42 % të fondit për investime.

### **Shpenzimet për karburant.**

Planifikimi i shpenzimeve për karburant dhe udhëtime e dieta për periudhën e audituar është bazuar në kërkesat sipas drejtorive për shërbimet që do kryhen në Qendrat e Integruara që administrohen nga ADISA dhe qendrat e reja që planifikohen të hapen.

Gjatë auditimit rezultoi se për vitin 2016 konsumi i karburantit për automjetet në dispozicion të institucionit është llogaritur me normativat e përcaktuara për to, të nxjerra nga katalogu i makinave.

Fletët e udhëtimit plotësohen në rregull, duke u nënshkruar nga përdoruesi i automjetit.

Bazuar në fletë-udhëtimet e automjeteve është shpenzuar karburant nga mjetet e transportit në gjendje pune në vlerën 149,916 mijë lekë e detajuar sipas tabelës së mëposhtme:

| Nr | Automjetet    | Targa     | Karburanti i harxhuar |               |                  |            |              |               |
|----|---------------|-----------|-----------------------|---------------|------------------|------------|--------------|---------------|
|    |               |           | Naftë                 |               |                  | Benzinë    |              |               |
|    |               |           | sasi                  | cmim          | vlerë            | sasi       | cmim         | vlerë         |
| 1  | Skoda YETI    | AA539 NN  | 930                   | 145.55        | 135,361.5        | -          | -            | -             |
| 2  | Skoda RAPID   | AA540 NN  | -                     | -             | -                | -          | -            | -             |
| 3  | Tojota PRIUS  | AA043 PL  | -                     | -             | -                | 20         | 145.55       | 2,911         |
| 4  | Tojota PRIUS  | AA044 PL  | -                     | -             | -                | 20         | 145.5        | 2,911         |
| 5  | Tojota PRIUS  | AA045 PL  | -                     | -             | -                | 20         | 145.5        |               |
| 6  | Tojota PRIUS  | AA046 PL  | -                     | -             | -                | 20         | 145.5        | 2,911         |
| 7  | Tojota PRIUS  | AA0306 PM | -                     | -             | -                | 20         | 145.5        | 2,911         |
|    | <b>Totali</b> |           | <b>930</b>            | <b>145.55</b> | <b>135,361.5</b> | <b>100</b> | <b>145.5</b> | <b>14,555</b> |

**Për vitin 2017 (6-mujori)** me urdhër nr. 263 prot, datë 08.08.2017 “Për ngritjen e komisionit për vlerësimin e harxhimit të karburantit të automjeteve të ADISA” është ngritur komisioni i përbërë nga 5 punonjës i cili ka bërë vlerësimin e normativave të konsumit të karburantit për 7 automjetet në pronësi të ADISA. Automjetet janë marrë në dorëzim nga ADISA me 0 km.

Në përfundim të verifikimeve nga komisioni janë mbajtur procesverbale të veçanta për çdo automjet duke përcaktuar dhe konsumin e karburantit për 100 km të përshkruar.

Bazuar në fletë-udhëtimet e automjeteve është shpenzuar karburant nga mjetet e transportit në gjendje pune në vlerën 241,486 mijë lekë e detajuar sipas tabelës së mëposhtme:



| Nr | Automjetet    | Targa     | Karburanti i harxhuar (litra) |               |                  |                 |               |                   |
|----|---------------|-----------|-------------------------------|---------------|------------------|-----------------|---------------|-------------------|
|    |               |           | Naftë                         |               |                  | Benzinë         |               |                   |
|    |               |           | sasi                          | cmim          | vlerë            | sasi            | cmim          | vlerë             |
| 1  | Skoda YETI    | AA539 NN  | 815                           | 157.64        | 128,476.6        | -               | -             | -                 |
| 2  | Skoda RAPID   | AA540 NN  | 130                           | 157.67        | 20,497.1         | -               | -             | -                 |
| 3  | Tojota PRIUS  | AA043 PL  | -                             | -             | -                | 376.05          | 153.97        | 57,900.4          |
| 4  | Tojota PRIUS  | AA044 PL  | -                             | -             | -                | 407.33          | 153.97        | 62,716.6          |
| 5  | Tojota PRIUS  | AA045 PL  | -                             | -             | -                | 200             | 153.97        | 30,794            |
| 6  | Tojota PRIUS  | AA046 PL  | -                             | -             | -                | 400             | 153.97        | 61,588            |
| 7  | Tojota PRIUS  | AA0306 PM | -                             | -             | -                | 185             | 153.97        | 28,487.45         |
|    | <b>Totali</b> |           | <b>945</b>                    | <b>157.64</b> | <b>148,973.7</b> | <b>1,568.38</b> | <b>153.97</b> | <b>241,486.45</b> |

### Gjetje nga auditimi

- Në përfundim të procesit të përcaktimit të normativës së harxhimit të karburantit u konstatua se mjetet Tojota PRIUS janë të një marke dhe të marra në dorëzim në të njëjtën datë me 0 kilometra, nga grupi i punës i ngritur për këtë qëllim duhej të dilte si normativë harxhimi për këto automjete mesatarja e matjeve të kryera për 5 automjetet.
- Për automjetet në pronësi të ADISA nuk ka libër automjeti ku të përcaktohen vlera e automjetit të bërë hyrje, shpenzimet për mirëmbajtjen, km e përshkruar, karburantin e furnizuar etj për secilin automjet.

U rekomandua që për periudhën në vazhdim të meren masa që për automjetet të cilat i përkasin të njëjtës markë dhe që janë bërë hyrje në të njëjtën ditë me 0 kilometra, të miratohet normativë e harxhimit të karburantit duke marrë mesataren e harxhimit të këtyre 5 automjeteve.

- Nga Sektori i Financës në bashkëpunim me Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse të çelet libri i shërbimeve të mirëmbajtjes për të gjitha automjetet.

Nga nëpunësi përgjegjës u kthye observacion lidhur me këto gjetje duke theksuar se

*Në projekt raportin Tuaj nuk ka konstatim në lidhje me shpenzimin e kryer për blerje karburanti, por me administrimin e tij. Sugjerojmë që gjetjet ti kalojnë për dijeni Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse”.*

**Koment:** Lidhur me këtë gjetje grupi i auditimit thekson se caktimi i normave të ndryshme të harxhimit të karburantit për 5 automjete me të njëjtat parametra bën që llogaritja e karburantit të shpenzuar të mos jetë e saktë, po kështu mbajtja e librit të automjetit i shërben Sektorit të Financës për llogaritjen e amortizimit të tyre bazuar në këto të dhëna, kështu që kjo gjetje qëndron dhe do të pasqyrohet dhe në Raportin Final të Auditimit.

**Zëri shpenzime për “Udhëtime e dieta”.**

Nga auditimi i urdhër shpenzimeve të përgatitura nga Sektori i Financës u konstatua se:



*Për vitin 2016 zëri “shpenzime për udhëtime e dieta” është realizuar në masën 91 % në krahasim me planin dhe paraqitet me një mosrealizim në vlerën 210 mijë lekë.*

Shpenzimet e realizuara për vitin 2016 për udhëtime e dieta brenda vendit janë të shoqëruara më Urdhër nga Titullari i Institucionit për ngritjen e grupeve të punës për nisjen për shërbim jashtë qendrës së punës , Urdhër shërbimi të plotësuar nga Nëpunësi Zbatues të niveleve të ndryshme , Fatura tatimore dhe Kuponi Tatimore i subjektit që ka kryer shërbimin (Fjetje) si dhe listë pagesat për punonjësit që janë nisur për shërbim konformë me VKM nr.997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiarë të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit” i ndryshuar.

Për shpenzimet jashtë vendit dokumentacioni bashkëngjitur urdhër shpenzimit është sipas VKM nr.870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”.

**Për vitin 2017 ( 6- mujori i parë) zëri “shpenzime për udhëtime e dieta” është realizuar në masën 26 % në krahasim me planin dhe paraqitet me një mosrealizim në vlerën 1,914 mijë lekë.**

Dokumentacioni shoqërues për shpenzimet e realizuara për udhëtime e dieta brenda vendit është konformë me VKM nr.997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiarë të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit” i ndryshuar.

#### **Gjetje nga auditimi**

*- Për periudhën e audituar dokumentacioni shoqërues( Kuponi Tatimore) i urdhër shpenzimeve për udhëtime e dieta brenda vendit jashtë qendrës së punës, i lëshuar nga subjekte të ndryshme (hotelet), është i pavlefshëm pasi nuk kanë të shënuar numrin e Fatures Tatimore ose numrin serial të saj bashkëngjitur këtij kuponi, veprim që bie në kundërshtim me Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipëris” i ndryshuar, VKM nr.781, datë14.12.2009, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.16, datë 03.05.2010 “Për administrimin dhe dokumentimin e procedurave të paisjeve fiskale” pika 2.5 si dhe VKM nr.997, datë 12.10.2010 “Për trajtimin financiarë të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit” i ndryshuar.*

*- Nga Sektori i Financës janë bërë pagesa për udhëtime e dieta brenda vendit por jashtë qendrës së punës duke i shkaktuar një dëm ekonomik ADISA në shumën 462,000 lekë, kjo e detajuar sipas pasqyrës përmbledhëse nr.2, si pjesë përbërëse e këtij raporti.*

**U rekomandua që nga Sektori i Financës të merren masa për arkëtimin e shumave të përfituara nga pagesa e udhëtimeve e dietave brenda vendit në shumën 462,000 leke, detajuar sipas të dhënave të paraqitura në pasqyrën nr.2 si pjesë përbërëse e këtij raporti.**

**Të nxirren personat përgjegjës për kryerjen e pagesave të shpenzimeve për udhëtime e dieta në kundërshtim me VKM nr.997, datë 12.10.2010 “Për trajtimin financiarë të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit” i ndryshuar.**

*Nga nëpunësi përgjegjës u kthye observacion lidhur me këtë gjetje duke theksuar se:*

*“ Referuar V.K.M nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit, pika 3/b dhe pika 4 citojmë:*

*3/b “Shpenzimet e fjetjes kundrejt dokumentit tatimor përkatës .....” IV “Dokument tatimor, për efekt të këtij vendimi do të konsiderohet çdo faturë tatimore e thjeshtë apo me TVSH, e cila detyrimisht duhet të shoqërohet me faturë të printuar nga kasa elektronike fiskale.”*

*Referenca ligjore të cilës i referoheni i përket subjektit tatimor për zbatim dhe jo punonjësit që merr shërbimin nga subjekti tatimor. Në të gjitha rastet, shpenzimet e fjetjes janë të shoqëruara me faturë tatimore dhe kupon tatimor.*

*Përsëri jemi para faktit që nga ana Juaj nuk është argumentuar se përse cilësohet si dëm ekonomik.*

*Nga verifikimi ynë në pasqyrën nr. 9 të projekt raportit ka vlera të dubluara të kuponëve tatimor si më poshtë:*

- Urdhër shpenzimi nr. 73 datë 19.04.2017 ka bashkëlidhur listë pagesën vetëm për punonjësin Eni Mirçe me vlerë kuponi tatimor 6,000 lekë. Në këtë urdhër shpenzim nga ana Juaj janë vendosur edhe emrat e punonjësve që i përkasin Urdhër shpenzimit nr. 74 dhe 75 datë 19.04.2017 ndërkohë që këto dy urdhër shpenzime i keni pasqyruar një herë. (Bashkëlidhur Urdhër shpenzimet dhe listë pagesat përkatëse)*
- Urdhër shpenzimin nr. 97 datë 11.05.2017 e keni dubluar me urdhër shpenzimin nr. 96 datë 11.05.2017. Ju sqaroj se emrat e dubluar nga Ju, janë paguar në urdhër shpenzimin nr. 96 (Eni Mirçe dhe Ilir Naqi Gjika); urdhër shpenzimin nr. 97 (Gëzim Kallajxhi) dhe urdhër shpenzimin nr. 98 (Arselda Gjura)*

*Në total vlera e kuponëve tatimor të vlerësuar nga Ju si të pavlefshëm rezulton në masën 462,000 lekë”.*

**Koment:** *Nga grupi i auditimit theksohet se në pjesën e parë të observacionit është cituar vetëm interpretimi i ligjit dhe VKM sipas Nëpunësit përgjegjës, duke bërë që observacioni të jetë i natyrës justifikuese, kështu që grupi i auditimit nuk e ndryshon opinionin e tij lidhur me këtë gjetje duke e pasqyruar dhe në Raportin Final të Auditimit.*

*Lidhur me urdhër shpenzimet të cilat janë dubluar nga ana jonë, pas verifikimit nga grupi i auditimit u konstatua se observacioni qëndron, kështu që në përfundim grupi i auditimit merr në konsideratë pjesën e observacionit në lidhje me dublimin e pagesave për udhëtime e dieta në*

vlerën 60,000 lekë duke ndryshuar opinionin e tij lidhur me shumën dhe personat përfitues sipas gjetjes (pasqyruar ndryshimi në pasqyrën nr.2).

Lidhur me argumentimin se pse jemi para një dëmi ekonomik në të dy rastet e cituar, si për pagesën e orëve shtesë në kundërshtim me VKM e cituar, ashtu dhe për rastin e pagesave të kryera për udhëtime e dieta kur dokumenti justifikues është i pavlefshëm, grupi i auditimit sqaron se mosveprimi i Nëpunësit Zbatues në të dy rastet ka shkaktuar një dëm ekonomik bazuar në “Ligjin Për Kodin Civil në Republikën e Shqipërisë”, mars 2017, Kreu I, Dispozita të përgjithshme, Përgjegjësia për shkaktimin e dëmit, neni 609 “Dëmi duhet të jetë rrjedhim i drejtpërdrejtë dhe i menjëhershëm i veprimit ose mosveprimit të personit. Mospengimi i një ngjarjeje nga personi që ka detyrimin ligjor për ta mënjeluar, e ngarkon atë me përgjegjësi për dëmin e shkaktuar”, si dhe Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 12.

**Konkluzion i përgjithshëm.** Në përfundim të auditimit rezultoi se Sektori i Financës ka një performancë të mirë gjatë periudhës së audituar, por referuar gjetjeve nga auditimi ka vend për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në drejtim të: mbajtjes, regjistrimit dhe azhurnimit në kontabilitet të dokumentacionit, përgatitjes së pasqyrave financiare për pasqyrimin e drejtë dhe të saktë të aktiveve të institucionit, përmirësimin e mbajtjes dhe azhurnimit të regjistrimit të aktiveve, kontrollit të shpenzimeve për udhëtime e dieta, pagesave për orët shtesë jashtë kohës normale të punës etj.

Në përfundim të auditimit për përmirësimin e punës në të ardhmen rekomandojmë:

## **V. PLAN VEPRIMI PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE.**

(Rekomandime sipas nivelit të drejtimit).

### **Rekomandim i lartë**

1. Për periudhën në vazhdim rekomandohet një impenjim më i madh në kërkesën e llogarisë për kompanitë ose subjektet e ndryshme me të cilat ADISA ka lidhur kontrata për realizimin e produktit në afatet e përcaktuara për kryerjen e punëve ose shërbimeve.

2. Të merren masa për paisjen me dokumentacionin e nevojshëm nga institucionet që janë marrë në dorëzim objektet (Vlerën fillestare të ndërtesës, rikonstruksionet e kryera ndër vite, amortizimin si dhe vlerën e mbetur të tyre,) më qëllim që këto aktive të regjistrohen në regjistrin e aktiveve gjatë vitit ushtrimorë 2017.

3. Të bëhet sistemimi i llogarisë 212 ‘Ndërtim e rikonstruksione’ në llogarinë 231 ‘Shpenzime në Proçess për Rritjen e AQT’ për vlerën 18,927,255 lekë (Krujë) deri në momentin që të regjistrohet në kontabilitet dhe vlera e ndërtesës ku është bërë ky rikonstruksion.

4. Për periudhën në vazhdim të merren masa për sistemimin e llogarisë së aktiveve në vlerën 127,680 lekë (për mos kuadrin me gjendjen fizike të kësaj llogarie) duke kryer sipas

*procedurave standarte ligjore inventarizimin fizik të aktiveve të institucionit dhe në rastet kur konstatohen teprica ose mungesa të kryhen sistemimet e duhura në kontabilitet.*

*5. Për përmirësimin e punës në të ardhmen të ushtrohen kontrole të vazhdueshme mbi dokumentacionin e mbajtur për evidentimin dhe lëvizjen e mallrave e materialeve në magazinë, nga magazinieri plotësimi i dokumentave të magazinës të bëhet në çast duke evidentuar hyrje - daljet brenda ditës. Regjistrimi në kontabilitet të kryhet në mënyrë sistematike dhe kronologjike, duke evidentuar mallrat dhe materialet e bëra hyrje - dalje të plotësohen kartelat për çdo mall dhe të kryhen rakordimet periodike me magazinën.*

*6. Për Automjetet në pronësi të ADISA të cilat janë evidentuar si aktive gjendje në magazinë (megjithëse përdoren për kryerjen e shërbimeve të ndryshme në funksion të institucionit) të priten fletëdaljet dhe sipas drejtorive të përcaktohen personat përgjegjës dhe të evidentohen në kartelën personale të çdo punonjësi që e mer në ngarkim, me qëllim ndjekjen dhe administrimin e karburantit dhe shpenzimeve të tjera që kryhet për çdo automjet.*

*7. Të përmirësohet regjistri i aktiveve i cili duhet të përmabjë të dhënat sipas Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kapitulli nr.3 “Regjistrimi i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, pika 30, duke përfshirë në këtë regjistër dhe ndërtesat që ADISA ka në administrim.*

*8. Të merren masa për arkëtimin e shumave të përfituara nga pagesa e orëve shtesë jashtë kohës normale të punës në kundërshtim me VKM nr.511, datë 24.06.2002 i ndryshuar, në shumën 1,155,734 lekë sipas të dhënave të paraqitura nga sektori i Financës pasqyruar në pasqyrën nr.1 pjesë përbërëse e këtij raporti.*

*9. Të nxirren personat përgjegjës për kryerjen e pagesave për orët shtesë jashtë kohës normale të punës, në kundërshtim me VKM nr.511, datë 24.06.2002 “Për kohëzgjatjen e punës dhe pushimit në institucionet shtetërore”, i ndryshuar.*

*10. Për atomjetet të cilat i përkasin të njëjtës markë dhe që janë bërë hyrje në të njëjtën ditë me 0 kilometrazh, të miratohet norma e karburantit duke marrë mesataren e harxhimit të këtyre 5 automjeteve.*

*11. Sektori i Financës në bashkëpunim me Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse të merren masa për çeljen e librit të shërbimeve të mirëmbajtjes për të gjitha automjetet.*

*12. Të merren masa për arkëtimin e shumave të përfituara nga pagesa e udhëtimeve e dietave brenda vendit në shumën 462,000 lekë, detajuar sipas të dhënave të paraqitura në pasqyrën nr.2 si pjesë përbërëse e këtij raporti.*

*13. Të nxirren personat përgjegjës për kryerjen e pagesave për udhëtime e dieta, në kundërshtim me VKM nr.997, datë 12.10.2010 “Për trajtimin financiarë të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit” i ndryshuar.*

**Ky Raport Final Angazhimi mbahet në 3 (tre) kopje origjinale, nga të cilat 1(një) kopje i dërgohen subjektit të audituar, 1(një) kopje dorëzohet në protokoll dhe 1(një) kopje mbahet nga Auditi i Brendshëm.**

## **GRUPI I AUDITIMIT**

Thoma PAPADHIMITRI

Shkurte HALILI